



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-

Tiranë, 22 Tetor 2008

**Njoftim**

**Mbi procedurat për kontrollin e përqendrimit të ARMO-AMRA OIL SHA**

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është paraqitur për shqyrtim rasti i përqendrimit të ARMO me shoqërinë e përbashkët Anika Mercuria Refinery Associated Oil (AMRA OIL SHA). Ky përqendrim i propozuar ka si objekt përfitim të kontrollit nëpërmjet shit-blejes së 85% të kapitalit aksionar me të drejtë vote në shoqërinë ARMO SHA nga shoqëria e përbashkët AMRA OIL SHA.

Njoftimi i pjesshëm i përqendrimit është dorëzuar pranë Autoritetit të Konkurrencës në datën 28 gusht 2008, me shkresën Nr 394 Prot.. ndërsa plotësimi i Formularit të Thjeshtuar të Njoftimit të Përqendrimit nga përfaqësuesit e palëve ka përfunduar në datë 17 tetor 2008.

Nga vlerësimi paraprak juridik dhe ekonomik i këtij përqendrimi, rezulton se mund të kemi tregje të prekura për shkak se realizimi i transaksionit mund të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në tregun shqiptar të karburanteve për sa i përket tregtimit të naftës dhe nënprodukteve të saj. Për këto arsye, Autoriteti i Konkurrencës ka kërkuar nga pala blerëse plotësimin e formularit të plotë të njoftimit të përqendrimit.

Sqarojmë se Autoriteti i Konkurrencës po e shqyrton këtë transaksion vetëm në kuptim të ligjit 9121 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" në bazë të neneve 10-17 dhe neneve 53-64 të këtij ligji.

Autoriteti i Konkurrencës mbetet i hapur për bashkëpunim me palët e përfshira në transaksion si dhe me të gjithë palët e interesuara për të përfunduar me sukses procesin e vlerësimit të këtij përqendrimi.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me Fax +355 4 234 497, me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr "Sami Frashëri", Nr. 4, Tiranë; apo me e-mail në adresën: [perqendrim@caa.gov.al](mailto:perqendrim@caa.gov.al); [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al)**